



**VENDIM**

**Nr. 125 Datë 28.10.2013**

**PËR  
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË  
“HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ” SH.P.K SI BURIM I  
RINOVUESHEM ENERGJIE NGA “HEC-ET “QARR” DHE  
“KALTANJ”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “ll”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, dhe neneve 7 e 8 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC-et “Qarr” dhe “Kaltanj” si burim i rinovueshëm energjie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.  
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.
- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.  
Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.
- **Neni 7 pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”**  
Përshkrimi i centralit.  
Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi :**

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ” sh.p.k si burim i rinovueshëm energjie nga Hec-et “Qarr” dhe Kaltanj”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s**

**Petrit AHMETI**